

Fjalim i deputetit Petrit Vasili

13.07.2023

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Absolutisht që ky raportim duhej të kishte qenë një kryeçështje, pasi vijmë pas zgjedhjeve vërtet të neveritshme, të cilat kanë verifikuar dhe provuar të gjitha llojet e formave të manipulimit mafioz politik, njëra më e shëmtuar se tjetra, njëra më e dënueshme se tjetra dhe njëra më e ligë se tjetra. Absolutisht, në këtë situatë, e cila vinte pas zgjedhjeve të mëparshme të vitit 2021, normalisht të gjithë kanë pritur, patjetër, një pozicion shumë ligjor, shumë të fortë e të pakapërcyeshëm, veçanërisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Por, mjerisht, ashtu sikurse nuk ka ndodhur në mënyrë të dukshme në të shkuarën, kur nuk ka qenë identifikuar si institucion që ishte në majën e problemeve të administrimit të paligjshmërisë, sot KQZ-ja, faktikisht është në pozicionin më të shëmtuar që mund të ekzistonte ndonjëherë, thjesht të një garantueseje të paligjshmërisë. Pas ndryshimeve të bëra përpara vitit 2021, kur u garantuan pafundësisht ndryshime ligjore, të cilat dënonin shumë rreptë, të paktën në ligj, përdorimin e administratës shtetërore dhe të të gjitha burimeve të tjera të të gjitha formave, ka ndodhur pikërisht e kundërta: kemi parë përdorimin më të përbindshëm, më të paparë ndonjëherë në historinë e Shqipërisë të administratës shtetërore, të kthyer në një detachment të neveritshëm në fuqi në zyrat e tyre dhe në çdo cep anembanë vendit, që nuk i shërbenin detyrës, por i shërbenin manipulimit të madh të zgjedhjeve.

E përballë tyre ishte një KQZ, thjesht dhe vetëm një zgjatim, një celulë politike shitesë e mazhorancës, që ishte streha më e mirë për të shuar e për të bërë zero mijëra shqetësime që janë bërë publike dhe formale me shkrim, zyrtarisht, duke u kujdesuar të mbante gjithmonë në dorë pompën e ujit të ftohtë për t'i shuar, për t'i asgjësuar e për të mos mbajtur kurrë qëndrim. Dhjetëra e dhjetëra dëshmi, fakte, njëri më tronditës se tjetri, që do të bënin të skuqej e të turpërohej këdo, në KQZ gjetën strehën, gjetën shfajësimin, gjetën alibinë, pasi kurrë nuk u trajtuan me seriozitet, kurrë nuk u trajtuan me të gjithë ashpërsinë e ligjit, përkundrazi u dha mesazhi i tolerancës së paparë, pra mund të vazhdoni të bëni ç'të doni se ne jemi në krahun tuaj.

Të gjitha strukturat në mënyrë të veçantë, KQZ-ja drejtpërdrejt, ku shpesh një shumicë dërmuese u soll si një KQZ politike e njëanshme në vend të një institucioni të paanshëm shërbëtor të ligjit, në mënyrë të veçantë Këshilli i Ankimeve dhe Sanksioneve, që praktikisht është një institucion i vdekur nga çdo pikëpamje, bënë të gjitha bashkë varrosjen e standardit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Sot, për fat të keq, ne jemi në një situatë, në udhëkryqin më të rrezikshëm që ka Shqipëria. Sot, ne flasim, dhe unë i bashkohem çdo diskutimi për të riparë çdo gjë, por praktikisht të gjithë duhet të jenë të bindur që me këtë situatë, me këtë Komision Qendror të Zgjedhjeve, me këtë sjellje të mazhorancës politike, të gjitha ndryshimet ligjore, të të gjitha formave qofshin këto, që nga

rregullimet e administrimit të zgjedhjeve e më tej ideja apo biseda për të folur për sistemin, rezultojnë një hiç, sepse në fund të ditës mekanizmi mafioz, manipulativ që fillon nga qeveria, e cila ka përgjegjësinë e administrimit të zgjedhjeve, deri te KQZ-ja, është një cirk i mbyllur që vret dhe asgjëson çdo lloj ideje apo edhe novatorizmi në drejtim të legjislacionit elektoral.

Kështu që, praktikisht, edhe KQZ-ja ka qenë një bashkëpjesëmarrëse në funeralin e standardit të zgjedhjeve dhe është, ashtu sikurse edhe institucione të tjera, nën akuzë si pjesë e këtij manipulimi në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të vetëdijshme. Kështu që besoj se gjithçka sot është betejë për një standard zgjedhjesh normale. Ky standard përfundimisht është rrënuar në Shqipëri.

Faleminderit!

XXXXXXXXXXXXXXXX

– E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa asnjë diskutim, çështja e sotme dhe raportimi i këtij institucioni vjen në një moment shumë delikat, për një arsye shumë të thjeshtë: qytetarët shqiptarë prej më shumë se një vit e gjysmë ndodhen nën shantazhin e vazhdueshëm të qeverisë për energjinë. Një herë kanë dëgjuar se do të vihesh fasha dhe pak muaj më parë dëgjuan t’u thuhet: “Prisni në gusht, se do të ndodhë rritja tjetër”. Pra, energjia është kthyer sa në një element presioni politik me synime të qarta për të realizuar qëllimet e ditës, aq edhe në një moment shumë të madh dhe të veçantë korrupsioni, ku paratë që shpërdorohen janë të frikshme.

Është e vërtetë që prodhimi i energjisë në vitin 2022 ka qenë 14% më i lartë se mesatarja e periudhës 2009-2022. Të gjithë pyesim: përse u vendos fasha? Çfarë lidhjeje kishte fasha, për më tepër kur bëhej fjalë për një vit mjaft të mirë hidrologjik? Çfarë ndodhi me historinë e fashës? Ju e mban mend, sepse kemi debatuar në këtë parlament, fasha u vendos dhe qeveria e mori, e mban në xhep dhe vendos ta përdorë sa herë të ketë nevojë. Besoj se këtu jemi në kushtet flagrante të një paligjshmërie të turpshme. Prandaj, sa herë do të kishte nevojë, pavarësisht se ishte një masë arbitrare, qeveria do të duhej t’i drejtohej institucionit përkatës, i cili raporton këtu, që të kishte të drejtë ta bënte këtë gjë.

Po sot, në këtë vit, i cili konsiderohet një vit akoma më i mirë energjetik, si shpjegohet që nuk vihet me propozim (ERE-ja mund ta kishte thënë këtë publikisht) për ulje çmimi? Rishikimi i çmimit në një vit, nuk do të thotë detyrimisht që çmimi të rritet, por sipas situatave çmimi edhe mund të ulet. Apo shqiptarët nuk kanë kurrë të drejtë të kenë mundësinë dhe fatin që çmimi i energjisë t’u ulet edhe kur Shqipëria, si këtë vit, kthehet në një eksportuese neto e energjisë

elektrike? Pra, qytetarët duhet ta kuptojnë se kanë një qeveri shpërdoruese, e cila me energjinë bën thjesht dhe vetëm pazar dhe korrupsion.

Njëherazi, duke lexuar raportin e ERE-s, ai të vë në vështirësi të mëdha për ta mirëkuptuar, kur thuhet se ERE-ja ka miratuar programe ekonomike dhe programe zhvillimi për energjinë, ndërkohë që TEC-i i Vlorës mbahet në konservim dhe kemi 2 gërmadha, 2 “xhenaze” të mëdha në mes të detit, komentet për të cilat janë një turp, që zhvatin para. Jam i bindur se specialistët e ERE-s, që janë profesionistë shumë të mirë, në këtë pikë, kanë bërë gjënë e vetmen që nuk duhet ta bënin: i janë nënshtruar presionit të qeverisë dhe nuk e thonë fjalën e tyre. Të gjithë shqiptarët e kuptojnë që ai është një turp i padëgjues, është një lubi që vetëm merr para, shkatërron natyrën dhe nuk sjell asnjë të mirë. Ndërkohë, ne paguajmë para për to, kur kemi energji me bollëk dhe jemi edhe eksportues neto. Pra, është shumë e vështirë t’ua shpjegojmë shqiptarëve që kanë të drejtë.

E gjithë situata në sektorin e energjisë ka rrjedhur nga një keqmenaxhim i tmerrshëm. Ne kemi pasur mundësi t’i diskutojmë borxhet në këtë sallë. Vetëm ujësjellësit kanë rreth 150 milionë euro borxh, ndërsa qytetarëve mendohet t’u rritet tarifa. A ka zullum më të madh, kur shqiptarët e varfër paguajnë, ndërsa kusarët e qeverisë kanë akumuluar borxhe kaq të frikshme? Nuk e di sa çfarë avokatie mund t’i bëhet nga mazhoranca kësaj gjëje! Duhet të kesh paturpësi të madhe t’i bësh avokati.

Njëherazi problematike është edhe situata në sektorin e gazit, ku, sado që flitet për të, me keqardhje mund të them se gjithçka është spontane, pra asgjë nuk është e planifikuar. Për të thënë të drejtën, mbeta i shokuar kur pashë në raportin e ERE-s që referohen konsulta me kompani, kur disave prej tyre u është hequr licenca. Si mund të komunikojë institucioni me kompani të cilave u është hequr licenca për perspektivën e gazit në Shqipëri?

I gjithë projekti tjetër dhe çdo gjë që lidhej me ndryshimet e koniunkturës në rajon, me ndryshimet në Greqi, në Kroaci, me prodhuesit e mëdhenj, sigurisht, kërkon që në këtë situatë të rishikohet me themel dhe me synime afatgjata strategjia e gazit.

Në këtë mënyrë, kemi një raport të shkruar mirë në excel, por përputhja e tij me realitetin ka diferenca të mëdha. Dua të besoj se kjo vjen vetëm nga një presion konstant, i palodhur dhe i paepur i qeverisë mbi institucionin, sepse nuk dua të besoj kurrë që profesionistët e këtij institucioni i besojnë të gjitha ato që kanë shkruar.

Faleminderit!